

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Përparim Zeka procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve A.D., nga fshati ... K.Drenas, për shkak të veprave penale Grabitja nga neni 329 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 i KP dhe të akuzuarit A.B. nga fshati ... K. Drenas, për shkak të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.1 i KP, duke vendosur përkritazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit A.D., ankesës së përfaqësuesit të palës së dëmtuar A.E. dhe ankesës së paraqitur nga vet i akuzuari A.B., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë PKR.nr.388/2017 datë 22.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 20.03.2018 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ajo e mbrojtëses së të akuzuarit A.D., e përfaqësuesit të palës së dëmtuar A.E. dhe ajo e paraqitur nga vetë i akuzuari A.B., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë PKR.nr.388/2017 datë 22.01.2018, **vërtetohet.**

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin PKR.nr.388/2017 datë 22.01.2018, e ka shpallur fajtor të akuzuarin **A.D.**, për shkak të veprave penale Grabitja nga neni 329 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 i KP, për çka për veprën penale nën pikën 1 të dispozitivit e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite si dhe dënim me gjobë në shumën prej 2000 (dy mijë) euro të cilën obligohet ta paguaj në dy rata-këste, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën ky dënim do të zëvendësohet me dënim burgimi ashtu që një ditë burgu do të vlej 20 euro. Për veprën penale nën pikën 2 të dispozitivit dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj. Në kuptim të nenit 80 të KP-së, i përcaktohet Dënim Burgimi-Unik, në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 3 (tre) muaj, në të cilin dënim llogaritet edhe qëndrimi në paraburgim prej dt. 24.11.2017 e tutje. Të akuzuarit **A.B.** për veprën të përshkuar në pikën 3 të dispozitivit të aktakuzës i përcakton dënim me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një) vit, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 2 (dy) viteve nëse i njëjti brenda

kësaj periudhe kohore nuk kryen vepër tjetër penale. Obligohen të akuzuarit që secili veç e veç ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës sipas llogarisë së kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësore të paguajnë nga 50 euro (pesëdhjetë) euro, brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit. E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil-juridik.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

- Prokuroria Themelore në Prishtinë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozim që ankesa të aprovohet në tërësi dhe aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj një dënim me të rëndë burgu.

- Përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. A.H. për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozim që Gjykata e Apelit ndaj të akuzuarit të shqiptoj dënim më të lart të mundshëm me burg.

- Mbrojtësja e të akuzuarit A.D., av. F.D., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozim që aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe ndaj të akuzuarit A.D. të shqiptohet një dënim me i butë e me të cilat do të arrihej qëllimi i dënimit.

-I akuzuari A.B., bazat ankimore nuk i ka theksuar por se nga përmbajtja e ankesës mund të konkludohet se aktgjykimin e atakon për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ta aprovoj kjo gjykatë ankesën e të njëjtin ta liroj nga akuza.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.103/2018 të dt. 07.03.2018 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë dhe ajo e përfaqësuesit të palës së dëmtuar të aprovohen ndërsa ankesa paraqitur nga mbrojtësja e të akuzuarit A.D. dhe ankesa e paraqitur nga vet i akuzuari A.B. të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit e Kosovës e caktoi seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPP-së, për të cilën i njoftoj palët, e në të cilën nuk prezantoi Prokurori i Apelit, ndërsa prezent ishte i akuzuari A.D. dhe mbrojtësja e tij av. L.K. të cilën gjykata ia caktoj sipas detyrës zyrtare pasi që mbrojtësja e tij av. F.D. nuk ka marr pjesë në seancë edhe pse e ftuar me rregull ndërsa mungesën e saj nuk e ka arsyetuar ndërsa i akuzuari A. u pajtua me mbrojtësen e caktuar nga ana e gjykatës. Prezent ishte edhe i akuzuari A.B. dhe përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar av. A.H. ndërsa e dëmtuara A.E. nuk ishte prezentë edhe pse e ftuar me rregull. Av.A.H. mbeti pranë pretendimeve të tij ankimore e po ashtu edhe mbrojtësja e të akuzuarit A.D. ndërsa i akuzuari Arjan e mbështeti ankesën e mbrojtëses së tij. Edhe i akuzuari A.B. mbështeti ankesën e tij.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

**-ankesat nuk janë të bazuara.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. I akuzuari A.B. ankesën e ka ushtruar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike por kjo gjykatë të njëjtën e ka refuzuar si të pa bazuar pasi që ndaj aktgjykimit nuk mund të ushtrohet ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike kur i akuzuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës e që në rastin konkret i akuzuari Argjend ka pranuar fajësinë dhe gjykata duke aplikuar dispozitat ligjore përkitazi me pranimin e fajësisë të njëjtin e ka shpallur fajtorë dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë. Sa i përket të akuzuarit A.D. gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorisë, përfaqësuesit të palës së dëmtuar, mbrojtëses së të akuzuarit A.D. dhe sipas detyrës zyrtare edhe për të akuzuarin A.B., nuk janë të bazuara. Në ankesa nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që kishte me ndikuar në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit, por prokuroria thekson se vendimi mbi dënim për të akuzuarin A.D. është shumë i butë pasi që me një dënim të tillë të butë të shqiptuar konsideron se të njëjtit mund të përsërisin veprat e tilla penale, mbrojtësi i të akuzuarit A.D. thekson se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese për të akuzuarin dhe se ka mbivlerësuar rrethanat rënduese, pasi që i mbrojturi i tij qysh në shqyrtim fillestar e ka pranuar fajësinë, i akuzuari A.B. në ankesën e tij thekson se ai e ndjen veten të pafajshëm për veprën për të cilën është ngarkuar pasi i njëjti nuk e ka ditë dhe nuk ka mund ta dijë se telefoni që e ka blerë është i përfituar me vepër penale ndërsa vendimin për dënim nuk e atakon por kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare të njëjtën e vlerësoi ndërsa përfaqësuesi i palës së dëmtuar thekson se dënimi i shqiptuar është simbolik në raport me veprimet dhe pasojat e shkaktuara për të dëmtuarën pasi që duke e marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës penale me një dënim të tillë të shqiptuar nuk arrihet qëllimi i dënimit. Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese që i ka konstatuar dhe vlerësuar drejtë gjykata e shkallës së parë dhe atë: se është i moshës relativisht të re, e pranon fajësinë për të dy veprat penale që i vihen në barrë, të cilin pranim e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës ndërsa si rrethanë rënduese mori parasysh ë rrezikshmërinë shoqërore, se veprën e ka kryer me dashje direkte-shkalla e lartë e dashjes, kohën e kryerjes së veprës penale në orët e mbrëmjes, kur ka kuptuar viktima jeton e vetme në shtëpi, mënyra e kryerjes së veprës penale, pas hyrjes me forcë në shtëpinë e të dëmtuarës përdor forcë duke e qëlluar të dëmtuarën me stupa në pjesë të ndryshme të trupit duke e përgjakur dhe alivanosur, veprën penale e ka kryer ndaj në gruaje të pa mbrojtur, me shiqim të dobësuar dhe shëndet

jo të mirë e cila ka jetuar e vetme, dhe gjithashtu edhe pse i akuzuari e pranon fajësinë me asnjë fjalë nuk shpreh pendim apo të kërkoj falje për atë që ka bërë. Kurse për të akuzuarin A.B. si rrethana lehtësuese gjykata e shkallës së parë mori parasysh se është i moshës relativisht të re, më parë i pa gjykuar, i vjen keq për blerjen e telefonit nga i akuzuari Arjan për të cilën thekson se sikur ta dinte se është i vjdhur nuk do ta kishte blerë, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
PAKR.nr.104/2018, më 20.03.2018

Procesmbajtësi,

Përparim Zeka

Kryetarja e kolegjit- gjyqtarja

1. Mejreme Memaj\_\_\_\_\_

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi\_\_\_\_\_

3. Afrim Shala \_\_\_\_\_